



KONTROLLI I LARTË I SHETIT KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax:042 232491

Nr. 1302/13 Prot.

Tiranë, më 30.04.2017

V E N D I M

Nr. 51, Datë 30/04/2017

PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TATIMORE DURRËS "MBI PËRPUTHSHMËRINË E VEPRIMTARISË SË DREJTORISË RAJONALE TATIMORE DURRËS ME KRITERET DHE KËRKESAT E KUADRIT RREGULLATOR NË FUQI"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin të paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeadituesi i Departamentit dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, me kriteret dhe kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi" për periudhën nga 01.01.2015 – 31.12.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit dhe Drejtorisë së Mbledhjes me Forcë të borxhit u konstatua se Sistemi i Ri Tatimor C@TS nuk u ka krijuar akses në sistem Drejtorive Rajonale Tatimore për

të prodhuar raporte që u nevojiten për të kryer analiza të ndryshme ekonomiko-financiare, krahasuar me pasqyrat financiare dhe deklaratat periodike, listën e subjekteve me borxh sipas llojit të detyrimit, verifikime të nevojshme për rimbursimin e tepricave kreditore të TVSH-së, si dhe humbjet e deklaruara në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor. Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, nuk i ka zbatuar rast pas rasti masat shtrënguese të përcaktuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore Në Republikën e Shqipërisë“ i ndryshuar nenet 88-101, si dhe kërkesat Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore nr. 8608, datë 04.10.2010, të Miratuar nga Ministri i Financave, për arkëtimin e borxhit tatimor dhe ndjekjen rregullisht të subjekteve të cilat kanë krijuar një borxh të ri gjatë vitit 2016 në vlerën prej 165,767 mijë lekë, nga të cilat Tatim fitimi, 31 raste të reja në shumën 1,258 mijë lekë, TVSH, 82 raste në shumën 40,809 mijë lekë, Sigurime shoqërore dhe shëndetësore, 274 raste në shumën 104,271 lekë dhe të tjera, 92 raste në shumën 19,429 lekë, mos derdhje e detyrimeve nga subjektet që kanë krijuar borxhin e ri nga 3-6 muaj gjatë vitit 2016, duke ndikuar negativisht në performancën e mbledhjes së të ardhurave për vitin 2016.

*Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet 72 dhe 191 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:***

DRT Durrës, të marrë masa duke shfrytëzuar hapësirat që krijon kuadri rregullator në fuqi për të vënë në lëvizje strukturat përkatëse pranë DPT por jo vetëm, për të krijuar mundësinë për DRT Durrës nga pikëpamja teknike për gjenerimin nga sistemi C@TS të raporteve sipas kritereve për analizën e subjekteve në mënyrë periodike, ndjekjen e tyre dhe vlerësimin sa më real të riskut në lidhje me performancën e subjekteve të biznesit. Gjithashtu të merren masa në mënyrë që të zbatohen në kohë dhe me efektivitet masat shtrënguese për arkëtimin e borxhit tatimor të pa paguar dhe ndjekjen me rigorozitet në mënyrë periodike të performancës së subjekteve me qëllim që borxhi i ri të jetë sa më natyral dhe të mos ndikojë negativisht në mbledhjen e të ardhurave të DRT Durrës.

Menjëherë

2. Plani i të ardhurave tatimore për vitin 2015 është realizuar në masën 106% ose në vlerën 10,010,643 mijë lekë. Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore rezultojnë me realizim në vlerën 5,885,429 mijë lekë ose në masën 107%. Të ardhurat nga TVSH rezultojnë me realizim bruto në vlerën 1,505,147 mijë lekë ose në masën 128% nga të cilat TVSH neto në vlerën 1,187,588 mijë lekë ose në masën 140% dhe rimbursimi i TVSH në vlerën 317,559 mijë lekë ose në masën 97%. Plani i të ardhurave tatimore për vitin 2016 është realizuar në masën 106% ose në vlerën 11,696,688 mijë lekë. Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore rezultojnë me realizim në vlerën 6,665,691 mijë lekë ose në masën 103%. Të ardhurat nga TVSH rezultojnë me realizim bruto në vlerën 1,850,895 mijë lekë ose në masën 103% nga të cilat TVSH neto në vlerën 958,690 mijë lekë ose në masën 67% dhe rimbursimi i TVSH në vlerën 892,205 mijë lekë ose në masën 255%. Për vitin 2015 të ardhura nga taksa kombëtare janë realizuar në masë 77%. Për vitin 2016 të ardhurat nga kjo taksë janë realizuar në masën 102%. Për zërin të ardhura nga

taksa e rentës minerare nuk ka subjekte që deklarojnë ushtrim të aktivitetit në referencë të kësaj takse.

Nga analiza e realizimit të të ardhurave nga Taksa Kombëtare u konstatua se mos realizimi i planit të parashikuar për vitin 2015 ka ardhur kryesisht nga mungesa e programimit të të ardhurave nga Drejtoria e Programimit të të Ardhurave, pranë DPT-së, mbasi nuk janë ushtruar kompetencat ligjore për të kërkuar realizimin e të ardhurave nga subjektet sipas programit për secilin taksa pagues, për të siguruar realizimin detyrimeve ligjore muaj pas muaji.

*Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet 82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:***

DRT Durrës, të analizojë faktorët dhe të propozojë në DPT bazën sa më reale të burimeve të disponueshme në territorin nën juridiksionin e DRT Durrës për taksat kombëtare me qëllim që ky zë të planifikohet sa më afër realitetit dhe në mënyrë të detajuar sipas llojit dhe strukturës me qëllim që veprimtaria për ndjekjen dhe realizimin e të ardhurave për këtë zë të bëhet më efektive dhe eficiente.

Menjëherë

3. Nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor nuk është realizuar plani i miratuar në total për kontrollet e plota tatimore, respektivisht realizimi i tij është në masën 90% për vitin 2015 dhe në masën 85% për vitin 2016 por në total kjo është kompensuar me kontrollet tematike. Mbështetur në realizimin faktik rezultojnë se burimet janë përqendruar më shumë në kontrollet tematike dhe vizitat fiskale për të dy periudhat ku dhe zbulimet për të dy llojet e kontrolleve, tematike dhe vizitat fiskale, janë të ulëta në raport me zbulimet nga kontrollet e plotë dhe konkretisht në masën 45% të totalit të zbulimeve për vitin 2015 dhe në masën 30% të totalit të zbulimeve për vitin 2016. Mobilizimi i burimeve në llojet e kontrolleve me zbulime më të ulëta se 50% të totalit paraqitet jo në eficientë e duhur.

*Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet 84 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:***

Drejtoria e Kontrollit Tatimor pranë DRT Durrës, të marrë masa për ta orientuar planifikimin e burimeve të disponueshme jo vetëm nga nevojat urgjente si ato të bazuara në kërkesat e subjekteve për rimbursim të TVSH por më shumë në një vlerësim sa më real të riskut duke vënë theksin tek kontrollet e plota dhe të thelluara ku dhe zbulimet nga kontrolli janë më të mëdha dhe, performanca më eficiente në këtë drejtim, rrit impaktin e veprimtarisë së kontrollit tatimor në mbledhjen e të ardhurave.

Menjëherë

4. Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor u konstatuan mangësi dhe shkelje të trajtuara në këtë raport të cilat janë rrjedhojë për sa inspektorët e kontrollit tatimor kanë trajtuar, analizuar e pasqyruar në raportin përfundimtar të kontrollit tatimor, të cilat në shumë raste janë të pa shpjeguara qartë, të pa analizuara e të pa argumentuara pasi nuk ka një analizë të hollësishtme të blerjeve e të shpenzimeve ku të argumentohen normativat e përdorimit të materialeve sipas manualeve përkatëse dhe se këto blerje e shpenzime i kanë shërbyer aktivitetit të prodhimit e të shitjeve,

nuk ka një analizë për diferencat e padeklaruar në të ardhura, nuk analizohen e kërkohen arkëtimet dhe pagesat e subjektit për periudhën ushtrimore, veprime që nuk përputhen me kërkesat e Manualit të Kontrollit nr. 5045, datë 22.02.2011 dhe bëjnë të pamundur aplikimin e procedurave dhe mjeteve të parashikuara nga manuali mbi indikatorët në të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit si dhe parashikimin e vështirësive në auditimin e tyre.

*Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet 85-167 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:***

Drejtorja e Kontrollit Tatimor pranë DRT Durrës, të marrë masa për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve profesionale, rritjen e mbikëqyrjes dhe monitorimit të kontrolleve tatimore duke mos lejuar mangësi në praktikën e kontrollit si dhe duke kërkuar në vazhdimësi aplikimin e metodave të parashikuara në manual si dhe akte vërtetuese bashkëlidhur raportit të kontrollit me qëllim rritjen e efektivitetit të kontrollit dhe respektivisht të auditimit të praktikës, si të jashtëm dhe të brendshëm.

Menjëherë

5. Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, pranë DRT-së Durrës u konstatua se; nuk janë ushtruar kontrollet e thelluara në ambientet e tatimpaguesve të deklaruar me humbje sipas listës së dërguar nga ish Drejtorja e Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit, që do të thotë se nuk janë zbatuar dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 80 “Kontrolli Tatimor”, pikat 1, 2 dhe 3 ku theksohet se; “Administrata tatimore kontrollon deklaratat tatimore, llogaritë, librat dhe regjistrimet tatimore të tatimpaguesit, përfshirë të gjithë dokumentacionin, që ka të bëjë me të ardhurat, shpenzimet, aktivet dhe pasivet, si dhe marrëdhëniet financiare me palë të treta”.

Në këto kushte Drejtorja e Kontrollit Tatimor, pranë DRT-së Durrës ka ngritur pretendimin se; tatimpaguesit e dërguar për kontroll të thelluar nga ish D.V.A.T.K-ja sipas listës nuk janë programuar për kontroll të thelluar me arsyetimin se; “orët e punës që kemi pasur në dispozicion si DRT, kanë qenë të pa mjaftueshme për ushtrimin e kontrolleve, mbasi janë shpenzuar për kontrollet tematike të rimbursimit të tepriçës kreditore të TVSH-së, si dhe për mbylljen dhe përthithje të tatimpaguesve”.

*Për sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 74-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit të Auditimit, **rekomandojmë:***

Autoriteti tatimor kompetent, Drejtorja Rajonale Tatimore Durrës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrin masat e duhura ligjore dhe administrative për të zgjidhur në një kohë sa më të shkurtër, problemet e konstatuara në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, me qëllim ushtrimin e kontrolleve të plota dhe sa më eficiente, në ambientet e tatimpaguesve që i kanë dorëzuar Pasqyrat Financiare dhe Deklaratat Vjetore të Tatimit mbi Fitimin me humbje, bazuar kjo në listën prej 50 subjektesh në vlerë 310,685,237 lekë, të dërguara nga ish DVATK-ja, cila përbën 16 % të numrit total të tatimpaguesve dhe 44 % të vlerës së humbjes të deklaruar gjithsej.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandojmë, Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, marrjen në shqyrtim të tyre, në lidhje me detyrimet tatimore dhe penalitetet të pa llogaritura dhe të pa kontabilizuara, të cilat në total janë në shumën **77,370,637 lekë**, për praktikatat e mëposhtme:

1. Për 17 raste (subjekte), nga kontrollet e ushtruara gjatë vitit 2015, për mos llogaritjen e detyrimeve tatimore e mos aplikim penalitetesh për vitet ushtrimore objekt i kontrolleve tatimore, në shumën prej **59,593,069 lekë**, pas rikontrollit tatimor, sipas aneksit nr. 1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit veprime që nuk përputhen me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 12.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar; ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar (*Trajtuar në faqet 81-169 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Menjëherë

2. Për 4 raste (subjekte), nga kontrollet e ushtruara gjatë vitit 2016, për mos llogaritjen e detyrimeve tatimore e mos aplikim penalitetesh për vitet ushtrimore objekt i kontrolleve tatimore, në shumën prej **8,663,429 lekë**, pas rikontrollit tatimor, sipas aneksit nr. 3, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit veprime që nuk përputhen me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 12.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar; ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar (*Trajtuar në faqet 81-169 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Menjëherë

3. Për 4 raste (subjekte), për periudhat tatimore 2015-2016, për mos llogaritjen e detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, TAP dhe mos aplikim penalitetesh në shumën prej **6,000,110 lekë**, detyrim për sigurimet shoqërore 4,265,369 lekë, penalitet 934,115 lekë, TAP 656,790 lekë dhe penalitet për TAP 143,836 lekë, sipas aneksit nr. 2, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprime që nuk përputhen me kërkesat e ligjit nr.75/2104, datë 08.08.2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike “Kontrata ndërmjet palëve” Neni 18, pika g) paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50 për qind më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave; ligjit nr. 9136, datë 11.02.2003 “Për mbledhjen e detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore” si dhe Udhëzimit të Ministrisë të Financave në zbatim të tij; dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, neni 115. (*Trajtuar në faqet 81-169 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Menjëherë

4. Për 9 raste (subjekte), nga kontrollet e ushtruara në terren gjatë vitit 2015, për mos llogaritjen e mos aplikim penalitetesh për akt konstatimet dhe procesverbalet respektive të mbajtura gjatë verifikimit në terren, në shumën prej **320,000 lekë**, sipas aneksit nr. 4, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, veprime që nuk

përputhen me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar si edhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” dhe jo sipas Manuali i Kontrollit në Terren “Për Organizimin dhe Funksionimin e Sektorit të Verifikimit në Terren”; KREU III, (*Trajtuar në faqet 162-169 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Menjëherë

5. Për 4 raste (subjekte), për mos llogaritjen e mos aplikim penalitetesh për tatimin në burim mbi qiratë e objekteve të marra me qira për ushtrimin e aktivitetit, në shumën prej **2,794,029 lekë**, sipas aneksit nr. 5, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, dhe mangësi pasi në listën e tatimpaguesve të regjistruar për tatimin në burim nuk pasqyrohet vlera e kontratës veç të tjerave edhe vlera e qirasë mujore që duhet të paguaj qiramarrësi, për qira-dhënësin në datë të caktuar të çdo muajit. Për pasojë nga disa subjekte likuidimi nuk është kryer në datën 20 të çdo muaji e përcaktuar në ligj, por me vonesë për 6 deri në 12 muaj, veprime këto që nuk përputhen me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” si dhe ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar (*Trajtuar në faqet 20-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, që në vlerësim të shkeljeve në RPA, të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe dhënien e masës disiplinore në bazë të nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”:

I. Për përgjegjësitë dhe të metat e konstatuara, sipas Nenit 58, germa **(b-ç)** nga **“mbajtje deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”** deri në **“Largim nga shërbimi civil”**, për nëpunësit civilë si më poshtë:

1. z. B. Sh.,
2. zj. M. S.,
3. z. Sh. P.,
4. z. F. Gj.,
5. zj. N. I.,
6. z. P. B.,
7. z. A. M.,
8. zj. D. B.,
9. z. B. L.,
10. z. D. D.,

11. z. D. D.,

12. z. K. R.,

13. z. N. D.,

me detyrë Inspektorë në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor.

Për mospërputhje të konstatuara sipas faqeve 80-162 ne RPA në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara Rregulloren së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608 prot, datë 04.10.2010 kryesisht për veprimet:

* jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;

* jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe referuar manualit të kontrollit tatimor në kontrollet tatimore të ushtruara nuk është kryer analizë të hollësishme e blerjeve dhe shpenzimeve ku të argumentohen normativat e përdorimit të materialeve sipas manualeve përkatëse dhe se këto blerje e shpenzime i kanë shërbyer aktivitetit të prodhimit e të shitjeve veprime në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Kontrollit nr. 5045, datë 22.02.2011; Nuk është kryer analizë të hollësishme për diferencat e padeklaruara në të ardhura për të cilën është deklaruar më pak edhe fitimi, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", Neni 71; Për shkeljet e konstatuara në Raportet e Kontrollit nuk janë aplikuar penalitetet në përputhje e zbatim të neneve 115, 116, 124, 128 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore ne RSH” i ndryshuar; Nuk është zbatuar plotësisht Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar kryesisht pika 57.1; Nuk është zbatuar plotësisht ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat “ , kryesisht neni 20; Është vepruar jo në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 56 dhe 71 i ndryshuar, me Vendimin nr. 781, datë 14.11.2007 i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16 datë 03.05.2010 dhe kryesisht për shitjet e pa deklaruara nuk është aplikuar TVSH-ja, në masën 20 %, në zbatim të nenit 41 të ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH” i ndryshuar.

14. z. A. C.,

15. z. I. T.,

16. z. A. B.,

17. z. R. S.,

18. z. D. B.,

19. z. B. G.,

20. z. A. D.,

21. zj. I. M.,

22. zR. R.,

23. zj. E. B.,

24. z. A. T.,

25. zj. M. R.,

26. zj. E. M.,

27. z. B. S.,

- 28. z. K. K.,
- 29. zj. B. L.,
- 30. z. Q. H.,
- 31. z. F. T.,
- 32. z. D. Ll.,
- 33. zj. V. T.,
- 34. z. D. Sh.,
- 35. z. F. T.,

në cilësinë ish/Inspektorë të Sektorit të Verifikimit në Terren 2015-2016 për mospërputhje në veprimtarinë e kontrollit në terren sipas akteve të mbajtura, të administruara në DRT Durrës me kërkesat e ligjit nr. 9920, 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, *trajtuar në faqet 162-169 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

II. Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, që në varësi të shkallës së shkeljeve në RPA, të vendosë mbi masa të mundshme disiplinore për:

- 36. z. R. M., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit Tatimor
- 37. z. D. Xh., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit Tatimor
- 38. z. E. V., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Verifikimit në Terren

D. PËR DREJTORINË E KONTROLLIT TATIMOR, DRT DURRËS.

Nga auditimi në DRT Durrës, u konstatuan të meta e mangësi në deklarin e të ardhurave dhe shpenzimeve në Raportin Përfundimtar të Kontrollit nr. 6246/4 prot, datë 03/06/2016, për subjektin “██████” shpk me NIPT ██████ dhe aktivitetet “Import-eksport, prodhim e shitje sheqeri të konfeksionuar dhe me thasë.” me objekt: kontrollin për TVSH^{në}, për vitet 02/2014-01/2016; kontrollin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 02/2014-01/2016 dhe për tatim fitimin për vitin 2013-2014 me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në shumën rreth 30 milion lekë. Duke qenë se KLSH e ka të pamundur të verifikojë të dhënat e deklaruara dhe të kontrolluara në subjekt, i kërkohet Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, që në bashkëpunim me strukturat kompetente të DPT, të verifikojë situatën mbi të dhënat e deklaruara nga subjekti “██████” në lidhje me të dhënat e pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Kontrollit Tatimor sa më sipër.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R

